



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. ...., datë .....2023

**MBI PROCEDURËN E PARAQITJES SË KËRKESËS, AFATET KOHORE,  
PËRGJEGJËSITË DHE ROLET E PËRDORUESVE TË SISTEMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 14 pika 1 e ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka si qëllim përfshirjen e programeve të strehimit social dhe aplikimit për të përfituar fonde nga buxheti i shtetit, nëpërmjet portalit e-Albania.
2. Individ iose përfaqësuesi/ja i/e familjes, që vetëdeklarohet me paaftësi apo pamundësi aksesi në rrjetin e komunikimeve elektronike, u drejtohet zyrave me një ndalesë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin ose vendqëndrimin. Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson kërkësën me dokumentacionin e nevojshëm për këta kërkues në portalin e-Albania.
3. Dokumentacioni i nevojshëm për të përfituar nga programet sociale të strehimit, i parashikuar në nenin 16 të vendimit nr. 384, datë 12.06.2019 të Këshillit të Ministrave “*Për percaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas cdo programi social të strehimit social*”, gjenerohet nga portali “e-Albania” pa pagesë, me përjashtim të vërtetimeve të lëshuara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për pasjen ose jo të pasurive të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to. Pagesa për tarifat e nevojshme për procesin e aplikimit për personat me aftësi të kufizuara apo dhe familjeve pa të ardhura sigurohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr. 22/2018 “*Për strehimin social*” të ndryshuar .

**II. PROCEDURA, AFATET KOHORE DHE PËRGJEGJËSITË**

1. Kërkesa për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, me përjashtim të rasteve të nevojës emergjente për strehim, bëhet në dy faza:
  - a) Në fazën e parë, kërkuesit bëjnë kërkesë pranë portalit e-Albania, për të përfituar nga programet e strehimit social, sipas ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar;
  - b) Në fazën e dytë përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë njoftuar nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania nga struktura përgjegjëse e strehimit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, si të përzgjedhur për t'u trajtuar me njërin prej programeve të strehimit.
2. Kërkesa përmban informacionin e parashikuar në pikën 8 të vendimit nr. 384, datë 12.6.2019, që mundëson përpunimin e të dhënave.
3. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, merr aplikimet e kërkuesve dhe në rastet kur kërkesa e aplikantit rezulton se ka të meta në dokumentacion, kjo strukturë, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës në sistemin e-Albania, njofton aplikantin nëpërmjet sistemit e-Albania të korrigojë pasaktësitë, duke përcaktuar afatin 5 (pesë) ditor për plotësimin e tyre. Kur kërkuesi nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar, kërkesa refuzohet dhe njoftohet nëpërmjet sistemit e-Albania në rubrikën mesazhet e mia.
4. Çdo individi/familje që paraqet kërkesën me dokumentacion e nevojshëm në portalin qeveritar e-Albania, nga sistemi merret konfirmimi që aplikimi është kryer me sukses.
5. Strukturat përgjegjëse për strehimin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ose zyra e shërbimit me një ndalesë e dedikuar për këtë qëllim, ofron ndihmë aktive për kërkesën në sistemin e strehimit në portalin qeveritar e-Albania, duke kryer plotësimin e formularëve të aplikimit për përfitimin nga programet e strehimit social për kërkuesit që kanë pamundësi për të aksesuar vetë në sistem.
6. Faza e dytë e aplikimit fillon kur njësia e vetëqeverisjes vendore planifikon zbatimin e njërit prej programeve apo instrumenteve të strehimit social, bazuar në kërkesat specifike të çdo programi. Njësia e vetëqeverisjes vendore ndjek procedurat, si më poshtë vijon:
  - a) Miraton çdo vit sistemin e pikëzimit. Sistemi i pikëzimit në total duhet të përbajë 100 pikë, ku çdo kriter i përcaktuar në nenin 16 të ligjit nr. 22/2018 të ndryshuar, përmban 25 pikë. Mënyra e shpërndarjes së pikëve, në përputhje me kriteret e përcaktuara, miratohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore me vendim të Këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili shpallet publikisht sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore dhe ngarkohet në sistemin e-Albania;
  - b) Njësia e vetëqeverisjes vendore rëndit kërkesat për strehim sipas sistemit të pikëzimit;
  - c) Njofton kërkuesit nëpërmjet sistemit e-Albania që janë përzgjedhur për fazën e dytë, për t'u trajtuar me një nga programet për plotësimin e dokumentacionit, duke i njoftuar, në çdo rast, edhe afatin 5 (pesë) ditor për plotësimin e dokumentacionit;
  - d) Kërkon dhe administron dokumentacionin e përmendur në pikën 16 të të vendimit nr. 384, datë 12.6.2019;
  - e) Bën verifikimin e kërkesave ta plikuesve sipas programeve të strehimit social, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e aplikimit;

- f) Harton dhe miraton listën e përfituesve, mbështetur në rënditjen e kërkesave;
- g) Njofton aplikuesit kandidat, që përfitojnë nga programet specifike të strehimit, si dhe ata/o që nuk kanë përfituar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit të listës së përfituesve nga Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të publikuar në e-Albania.
7. Aplikantëve jofitues, struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore u njofton nëpërmjet e-Albania edhe arsyet e kësaj vendimmarjeje. Vendimet e marra përfshijnë edhe përcaktimin e mjetit ligjor mbrojtës, si dhe afatet kohore për ushtrimin e kësaj të drejte.
8. Në fazën e dytë, dosja e çdo kërkuesi e cila ngarkohet në sistemin e-Albania, duhet të përbajë dokumentacionin që vërteton deklarimet e bëra në fazën e parë. Dokumentacioni që kërkohet dhe ngarkohet në fazën e dytë është ai i përcaktuar në pikën 16 të vendimit nr. 384, datë 12.6.2019, me përjashtim të aktverifikimeve që kryen në terren njësia e vetëqeverisjes vendore lidhur me kushtet e banesës.
9. Dokumentacioni i parashikuar pikën 8 të këtij kreu, ngarkohet nga vetë kërkuesi, me përjashtim të rasteve kur sigurimi i tyre është i pamundur për shkak të situatave të dhunës në familje, e vërtetuar me urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata. Për kërkuesit viktima të dhunës në familje të dhunuara kërkohet vetëm dokumentacioni sipas nëndarjes "vi", të shkronjës "ç" të pikës 16 të vendimit nr. 384, datë 12.6.2019. Në këto raste dokumentacioni tjetër i parashikuar në pikën 16 të vendimit nr. 384, datë 12.6.2019, sigurohet nga vetë struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe ngarkohet në sistemin e-Albania.
10. Kërkuesit që janë në kushtet e nevojës emergjente për strehim, që janë ata individë/familje që banojnë në banesa në rrezik shembjeje, në banesa që nuk plotësojnë kushtet higjieno-sanitare, në banesa në proces legalizimi që pësojnë dëme për shkak të fatkeqësive natyrore, në banesa që prishen për shkak të ndërtimeve të veprave publike, të cilët nuk përfitojnë kompensim finansiar nga procedurat e shpronësimit, dhe të ndërtimeve në proces legalizimi që nuk legalizohen, dhe ato familje/individë, të cilët ndodhen në kushtet e situatës së dhunës në familje, e vërtetuar me urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje lëshuar nga gjykata, paraqesin kërkesën në sistemin e-Albania, duke specifikuar edhe situatën në të cilën gjenden. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore shqyrton menjëherë kërkesën dhe, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, verifikon situatën në terren. Gjendja e verifikuar pasqyrohet në një procesverbal që mbahet nga struktura përgjegjëse për strehimin dhe firmoset edhe nga aplikanti dhe ngarkohet në sistemin e-Albania.
11. Lista e përfituesve hartohet nga zyra përgjegjëse e ngarkuar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e kërkuesve dhe dokumentacioni përkates vlerësohen nga komisioni i strehimit dhe miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Pas marrjes së fondit takues nga buxheti i shtetit, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, brenda 10 (dhjetë) ditëve, miraton listen përfundimtare të përfituesve, të cilën e shpall publikisht sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore në fuqi. Vendimi ngarkohet në sistemin e-Albania në rubrikën e posacshme.

12. Organet e vetëqeverisjes vendore bëjnë publike në portalin qeveritar të e-Albania, nëpërmjet mjeteve të informimit publik në faqet e tyre të internetit dhe shpalljes në vende të dukshme, pranë institucionit të tyre, mbi shpalljen e programeve të strehimit social sëbashku me afatet kohore
13. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësitë e vetëqeverisjes vendore administron dhe përditëson regjistrin e individit/familjeve në listat pritëse.
14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore informojnë çdo vit ministrinë përgjegjëse për strehimin për nevojat për strehim, të identikuara në përputhje me këtë vendim, nëpërmjet kërkesave për strehim social.

### **III. DISPOZITAT E FUNDIT**

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, ministria përgjegjëse për strehimin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi RAMA**